

Njoftim për përqendrim me të cilin personi fizik Erxhan Sulkoski, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, fiton kontroll mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup

(lënda nr. 08-87/2025)

Në pajtim me nenin 15 të Ligjit për mbrojtje të konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 16.05.2025, si dhe të plotësuar më 05.06.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin personi fizik Erxhan Sulkoski, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, fiton kontroll mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup, me seli në rr. Dame Gruev nr. 16, Shkup.

Përqendrimi është realizuar në vitin 2022.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Personi fizik Erxhan Sulkoski është pronar i vetëm i Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime PACIFIK PETROLEUM import-eksport SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Dane Krapçev nr.12, Shkup. PACIFIK PETROLEUM import-eksport SHPKNJP Shkup ka si veprimtari kryesore transportin e mallrave dhe posedon Licencë për kryerjen e transportit publik të mallrave dhe Leje për kryerjen e transportit të materieve të rrezikshme në trafikun rrugor, me ç ‘rast kryen transport të materieve të rrezikshme si: Eurosuper BS – 95, Eurosuper BS – 98, Eurodizel BS (D-E V), Ekstra i lehtë 1 (EL-1) dhe GPL (gaz i lëngshëm nafte).

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup kryen tregti me shumicë të lëndëve djegëse në gjendje të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë, dhe atë tregti me shumicë të Mazutit (M-1).

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtje të konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim deri te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr.54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë deri te Komisioni brenda afatit prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

10.06.2025

Shkup